



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

Aferdita Kelmendi
Pronar
21 KIDS
OSHP 10
Pallati i Mediave, Aneksi 2
Prishtinë

VENDIMI: LIC/KPM-2012/15
Ref:1211/1100/KPM/ni

VENDIM

në lidhje me kërkesën e Ofruesit të Shërbimeve Programore 21 KIDS për ndryshimin e emrit në 21 JUNIOR

Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audiovizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Ofruesi i Shërbimeve Programore (OSHP) 21 KIDS, me seli në Prishtinë, është pajisur me licencë të KPM-së me 5 dhjetor 2008, për të vepruar si OSHP.
3. KPM, me datën 21 maj 2012, ka pranuar kërkesën nga pronari i 21 KIDS për ndryshimin e emrit nga 21 KIDS në 21 JUNIOR.

Arsyetim

4. Kërkesa për ndryshimin e emrit të OSHP 21 KIDS në 21 JUNIOR është bërë për shkak se, emri i propozuar është më i përshtatshëm për rritjen e shikueshmërisë së Ofruesit të Shërbimeve Programore.
5. Kërkesa e pronarit të 21 KIDS për ndryshim të emrit të këtij OSHP, nuk paraqet asnjë ndryshim tjetër në Pakon e Licencës së KPM-së për këtë OSHP.


6. Emri i propozuar 21 JUNIOR, për t'u identifikuar në të ardhmen si OSHP në Republikën e Kosovës, nuk është i ngjashëm me asnjë nga emrat e subjekteve transmetuese të licencuara nga KPM dhe që operojnë në Republikën e Kosovës.

Vendim

7. Komisioni i Pavarur për Media, konkludon që ndryshimi i emrit të OSHP 21 KIDS, në 21 JUNIOR nuk paraqet ndryshime në pronësi apo në skemën e programore.
8. Komisioni i Pavarur për Media, merr vendim që OSHP 21 KIDS t'i lejohet ndryshimi i emrit në 21 JUNIOR.

Lëshimi i Vendimit

9. Këtë vendim e lëshon Komisioni.



Shefki Ukaj
Kryetar
Komisioni i Pavarur për Media





datë